



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më 28.08.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

ME
OBJEKT

**“PUNIME PËR NDËRTIM TROTUARI, NDRIÇIM RRUGOR E VESHJE KANALI
NË RRUGËN E “VARREZAVE NIKËL”, NJ.A.NIKËL, BASHKIA KRUJË”.**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me 28.08.2026 ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit ‘E Hapur e Thjeshtuar’ dhe ne referim te urdherit te prokurimit **nr. 439 Date 28.08.2026** , me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Punime për ndërtim trotuari, ndriçim rrugor e veshje kanali në rrugën e “Varrezave Nikël”, Nj.A.Nikël, Bashkia Krujë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pune Ndertimi / (45000000-7)

VLERA E FONDIT LIMIT: : 8’305’291(tetemilion e treqind e pese mije e dyqind e nentendhete e nje) lekë pa t.v.sh, vënë në dispozicion nga të Ardhurat e Bashkisë Krujë.

- Likuidimi per vitin ushtrimor **2026** eshte **2’471’958** (dymilion e katerqind e shtatedhete e nje mije e nenteqind e pesedhete e tete) leke pa t.v.sh dhe 2’966’349 (dymilion e nenteqind e gjashtedhete e gjashte mije e treqind e dyzet e nente) leke me t.v.sh dhe per vitin **2027, ne shumen prej 5’833’333**(pesemilion e teteqind e tridhete e tre mije e treqind e tridhete e tre) leke pa t.v.sh dhe 7’000’000(shtatemilion)leke me t.v.sh, vënë në dispozicion nga të Ardhurat e Bashkisë Krujë.

BURIMI I FINACIMIT:Te ardhurat e Bashkise Kruje.

AFATI I REALIZIMIT: 45 (dyzet e pese) dite nga data e fillimit te punimeve.

LLOJI I PROCEDURES :PROCEDURE E HAPUR E THJESHTUAR

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kruje** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Ne raportin prej 2% te vleres se fondit limit te objektit te prokurimit).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2026 per secilin operator).*

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2026 per secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.2-a)Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

b)Liçensa profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit te leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures/MIE.

Shoqeria ofertuese duhet te paraqesi licensen e shoqerise te vlefshme per pikat dhe klasifikimin si me poshte vijon:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

-NP-1/A→Punime gërmimi në tokë.

-NP-4/A→Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

-NP-11/A→Punime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

-NS-18/A→Punime topogjeodezike.

Shenim-Licensa duhet te jete leshuar ne perputhje me kerkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” te ndryshuar me VKM nr nr. 92 datë 19.02.2014.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008 si dhe VKM 729, dt.12.11.2014 ndryshuar me VKM 943.DT 28.12.2016). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë	Punime gjurmimi në tokë. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve të gjurmimit, sipas zërit nr.1, 2, 3, 4, 5 të preventivit.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM nr 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NP -4	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve rrugore, sipas zërit nr.6, 7, 8, 9, 10, 11, 20, 21 të preventivit.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM nr 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar

NS-11	Punime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve rrugore, sipas zërit nr.6, 7, 8, 9, 10, 11, 20, 21 të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NS -18	Punime Gjeodezike	Punime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve elektrike, sipas zërit nr.12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kritereve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.1.a)-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2023,2024,2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres se fondit limit te kontrates qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **3’322’116 (tremilion e treqind e njezet e dy mije e njeqind e gjashtembedhete) lekë pa t.v.sh.**

Shenim-Pika 2.2.1-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rendesishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e nën kufirin e ulët monetar dhe iu jep mundësinë ndër të tjera dhe operatorëve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

Teresia e kriterëve që i perkasin kapacitetit teknik si pjese integrale e kriterëve të vecanta është hartuar nga DPZHT, dhe janë përcjelle në NJ.P.P me shkresën nr. _____ Prot , date, _____.____.2026.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

2.3.1:-Operatorët ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshtë në ekzekutimin e kontratave të:

a)punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30 % e vlerës së përllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht në shumën 2'491'587 (dymilion e katerqind e nentdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh** dhe që është realizuar gjatë 5(pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b)punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5(pese) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht, **8'305'291(tetemilion e treqind e pese mijë e dyqind e nentdhjetë e një) lekë pa t.v.sh) lekë pa t.v.sh.**

Shenim- Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme

c)Pika "2.3.1/a" plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika "2.3.1/b " duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim:Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

d)Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentat e mëposhtme provuese:

i-Per punimet e kryera ne sektorin publik duhet te paraqitet dokumentacioni provues te meposhtem si vijon i vlefshem:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 09, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar te objektit ;
- Fatura tatimore perfundimtare te shitjes te deklaruar ne organet tatimore .
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim

ii-Ndersa ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin provues te meposhtem te vlefshem :

- Kontraten e sipermarrjes
- Situacionin përfundimtar te objektit
- Akt kolaudimin e objektit .
- Faturat tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore .

(Elementet provues te mesiperm jane kerkuar ne referim te legjislacionit perkates ne fuqi per disiplinimin e kontrollin e punimeve te ndertimit e me konkretisht ne referencat e dizpozitave te Ligjit Nr.8402, Date 10.9.1998 ‘Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit’ i ndryshuar ,dhe VKM nr 408 date Nr. 408, datë 13.5.2015’’ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit’’ i ndryshuar.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat, 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose .jo me te vogel se vlera e fondit limit te objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Marzhi i mesiperm eshte konsideruar i tille qe pare ne aspektin e ofertimit iu jep mundesi dhe akses pjesemarrje ne konkurim edhe subjekteve ofertues te cilet jane biznese te vegjel ose te mesem duke zgjeruar hapesiren e ofertimit.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar

përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave perkatese te DST, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukshtë kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku percaktohet ndarja e perqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Marzhi i mesipër është konsideruar i tillë që parë në aspektin e ofertimit iu jep mundësi dhe akses pjesëmarrje në konkurim edhe subjekteve ofertues të cilët janë biznese të vegjël ose të mesëm duke zgjeruar hapësirën e ofertimit.

2.4.3-a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, staf inxhinierik si më poshtë për të cilin duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme (me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.

-Inxhinier Ndertimi/ ing.rruga ura/ ing.transporti →1 inxhinier.

-Inxhinier Gjedodet/Ting.opograf →1 inxhinier.

Shënim- Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacioninteknik dhe zërat e punimeve. Vendosija e këtij kriteri

per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje afat **kohor qe i perket realizimit te punimeve ne nje afat prej prej 45(dyzet e pese) dite**, i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate. Kapaciteti per fuqi punetore inxhinierike per stafin e kerkuar inxhinierik bazohet ne K.Punës, dhe ne V.K.M. nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar dhe lidhet ngushtesisht me nevojën për realizimin në kohe të objektit të kontratës duke iu referuar zbatimit të punimeve, si dhe ne perputhje me zerat dhe volumet e punimeve të preventivit sipas projektit të zbatimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi/t i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.5.3.-Personeli dhe fuqia punetore:

a)-Kandidati/ofertuesi/ Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën **15 (pesëmbëdhjetë) punonjesve** duke përfshirë personelin teknik , drejtuesit teknik si dhe mbeshtetes , për periudhën **e muajit të fundit të deklarimit tatimor** ,duke nisur nga data e hapjes së ofertave/shprehjes se interesit. te provuar , si më poshtë:

- Vertetim të leshuar administratë tatimore kompetente sipas legjislacionit fiskal në fuqi ku të specifikohet nr. total i punonjesve për të cilët derdhet kontribut sigurimi shoqëror/shendetësor sipas legjislacionit në fuqi .

Ose

- Listepagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 025) sipas formatit elektronik në përputhje me VKM nr 922 datë 29.12.2014”**Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.**

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje **muajin e fundit të vlefshëm të deklaramit sipas legjislacionit tatimor ne fuqi** tregon besueshmëri/garanci për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje **muaji**

e fundit të vlefshëm të deklaramit sipas legjislacionit tatimor ne fuqi tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Vendosja e kriterit për njëpunësim të paktën 15 **(pesëmbëdhjete) punonjësve**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në **VKM nr.216 DT 13.04.2023'' Sistemi i Integruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim''**.

2.5-6-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe Teknik

2.5.6-a)-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator (Rruli vibrues/ grejderi) →**1 manovrator**

Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës) si dhe dëshmia e aftësive profesionale për përdoruesit e makinerive të renda (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente përkatëse sipas modaliteteve të **urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019**

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin e drejtuesve të mjeteve motorike dhe atyre **te makinerive të renda**, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për shoferet/manovratorët/drejtuesit të mjetit në objekti konkret është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe qarkullimit të mjeteve dhe certifikimit të personelit të drejtuesve të mjeteve të qarkullimit rrugor të makinerive të renda. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezultojnë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve prandaj disponimi i tyre është faktor i rëndësishëm për përmbushjen me sukses të kontratës së sipërmarrjes së punëve të ndërtimit sipas natyrës së projektit të zbatimit. Numri i profilit të personelit të mesipër , është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve, duke patur në konsideratë zërat e punimeve të preventivit të zbatimit.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë.

2.5.6-b)-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë shofere/drejtues mjeti gjithsej **3(tre) punonjes të drejtimit të automjeteve** të profileve të mëposhtme:

- Shoferë kamioni→**1 shoferë**,
- Shoferë autoboti→**1 shofer**
- Shofer Kamioni me Vinc→**1 shofer**

Për cdo profil të shofereve të mesipër nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqitet si prova apo dëshmi të disponimit të tyre të dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontrata individuale punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës).
- Leja e Drejtimit për kategorinë përkatëse sipas kërkesave të rregulloreve në fuqi të miratuara nga autoritetet kompetent publike (e vlefshme).
- Dëshmitë e aftësive profesionale ose Certificate të Aftësive Profesionale(CAP)(të

vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese/autoritetet kompetente sipas rregullave te qarkullimit rrugor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise sipas kategorise respektive te mjetit .

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore te disponimit te shofereve te mjeteve motorike sipas profilit te tyre eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, si dhe ne raport te nderlidhur me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlogaritur nenje kohe te percaktuar prej 36(tridhete e gjashte) dite , afat i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.Gjithashtu per profilin e manovratoreve/shofereve/drejtuesve te mjeteit eshte marre ne konsiderate direkte natyra e zerit te punimeve perkatese te cilet mund te zbatohen vetem nepermjet proceseve te mjeteve e makinerive te vecanta.

2.3.5-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

I.MAKINERI	Njësia	Sasia	Pronësia
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç.	copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator.	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	copë	1	Pronësi ose me qera
II.PAJISJE			
Betonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator (betoni).	copë	1	Pronësi ose me qera
Jelekë fosforeshentë/uniforma pune.	copë	23	Pronësi ose me qera
Kallëp dërrase.(armaturë).	m2	100	Pronësi ose me qera
Karroca dore.	copë	1	Pronësi ose me qera

Tabela rrugore (për punime në rrugë).	copë	4	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	23	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

1. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi duhet të paraqitet a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit ne pronesi **leja e qarkullimit (e vlefshme)** - b) **çertifikaten e kontrollit teknik** (e vlefshme); c) **siguracionin e detyrueshem te mjetit sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi** (i vlefshëm); d) **Çertifikatë transporti mallrash sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi** (e vlefshme), Ndersa per mjete te marra me qira/perdorim krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet/n edhe **kontrata/t përkatëse te qerasë/marrjes ne perdorim** e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.
2. Për mjetet/pajisjet/makinerite te cilat nuk i nenshtrohen detyrimit ligjor per tu rregjistruar në regjistra publikë, **kur janë ne pronesi**, duhet të paraqitet dokumenti qe verteton titullin e pronesise te vlefshem si kontrata e shitblerjes /akti çdoganimi/ fatura tatimore e blerjes perkates/e, **ndersa per mjete te marra me qera/perdorim** krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/marrja ne perdorim e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.
3. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
5. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 08.pika C (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
6. Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, **sipas shtojcës nr.8**, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar zerave respektiv te punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në analiza të mbeshetur ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në fuqi për disiplinimin e punimeve të ndertimit. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, specialisti perkates është mbeshetur teresisht në analizave teknike të cmimeve dhe kostot e fuqisë e punetorisë dhe makinerive të hartuara nga ana e autoreve të projektit të zbatimit, në referim të çdo zeri punimesh i pasqyruar në preventivin e punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në **VKM nr.216 DT 13.04.2023** “Sistemi i Integruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim”.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

- Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te analizave teknike te hartuara nga ana e autoreve te projektit te zbatimit
- Projekti zbatimit, Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe jane pjese e DST.
- Ne çdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent.
- Shenim: Gjithashtu ne specifikimet teknike te referuara ne dokumentat aktual te ngarkuar , ne pjesen ku citohet teksti..., “**UNI 6132-72, UNI 7163-79,...etj...**”, do te shtohet fjala **ose ekuivalente ose SSH/UNI/ISO** .

Shenim:Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr.216 DT 13.04.2023” Sistemi i Itegruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim”.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2,55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMEVE PUBLIKE